

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E ENJTE 16 DHJETOR 2021

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa asnjë paragjykim apo ndjenjë mosbesimi ndaj zonjës ministre, por me bindjen se këtë ndjeshmëri, njësoj si unë, e kemi të gjithë në këtë sallë, me përgjegjshmërinë që duhet të na karakterizojë të gjithë deputetëve, kam kërkuar këtë seancë pyetje-përgjigje me ministren e Arsimit dhe Sportit, zonjën Evis Kushi, duke marrë shkas nga rasti skandaloz kur një mësues, i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për ngacmim seksual e pedofili në vitin 2003, ka arritur të rikthehet në sistemin arsimor dhe të emërohet sërish si mësues në shkollën “22 tetori” në Berat. Rasti është denoncuar në medie dhe është bërë publik nga prindërit dhe nxënësit, të cilët të shqetësuar me të drejtë e kanë bërë publik këtë fakt. Kësisoj, pyetja që bën secili prej nesh, por edhe çdo qytetar është: mbi çfarë kriteresh është bërë rekrutimi dhe emërimi i Engjëll Bregut, i dënuar më parë për pedofili dhe ngacmim seksual, mësues i shkollës “22 tetori” në Berat dhe cilët janë mekanizmat që keni ju për të garantuar mbrojtjen e nxënësve të shkollave nga individë me të kaluar kriminale? Pra, si është e mundur që një person, i cili ka marrë një vendim të formës së prerë, të ketë mundësinë të bëhet pjesë e sistemit arsimor? Çfarë praktikash ndiqni ju, kur raportohet një ngacmim seksual? Çfarë procedure monitorimi keni ndërtuar ju që këta persona të evidentohen dhe të mos jenë përsëritës? Këto janë pyetjet thelbësore që çdo familje shqiptare i bën sot, pasi ky rast dëshmon se sistemi i përzgjedhjes së mësuesve është korruptiv dhe krijon hapësira që të dënuarit për krime seksuale dhe pedofili, të emërohen në detyrën më fisnike të mësuesit. Por, gjithashtu, ky rast është prova se sa të vonuar jemi ne në miratimin e ligjit “Për regjistrin kombëtar të të dënuarve seksualë”, që do të ishte një mekanizëm, i cili do t’i parandalonte raste të tilla.

Kështu, miratimi sa më parë i tij sot është një emergjencë që të mund të ndalojmë me ligj hyrjen në sistemin arsimor apo në institucione publike dhe private të këtyre grabitqarëve seksualë që kërcënojnë fëmijët tanë. Faleminderit!